



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivary	06-07-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOC	3953	2022	114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.477/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.477/2022 të datës 25.05.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë

[redacted] kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, respektivisht kundër organit të punësimit/Agjencia për Pronësi Industriale-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Vlerësimi i punës për vitin 2021", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.07.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.477/2022 e datës 26.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II Mbetet në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësit Civil i datës 24.04.2022, për periudhën 28/07/2021 deri më 31/12/2021.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Zyrtar për të hyra financiare" sipas Akt emërimit të datës 21.06.2019 në Agjencinë për Pronësi Industriale/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Me datë 03.02.2022 është vlerësuar për pesë(5) muajt e fundit të vitit 2021 duke e vlerësuar ankuesin me notën e përgjithshme 2.2 ndërsa për periudhën Janar - Korrik ankuesi nuk është vlerësuar.



I pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, ankuesi me datë 23.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 952/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 03.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë /Agjencia për Pronësi Industriale, ndërsa me datën 11.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Departamenti i Burimeve Njerëzore me datë 04.03.2022 përmes e-mail-it zyrtarë është vënë në dijeni për mos pranim të vlerësimit të performancës nga ana e zyrtarit me ç' rast nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka kërkuar rivlerësim të performancës në punë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me datë 08.04.2022 merr vendimin me numër A.nr.159/2022 me të cilin vendim anulohet vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin si dhe është obliguar Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor për pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale/MINT pas pranimit të Vendimit A.nr.159/2022 të datës 08.04.2022, ka bërë zbatimin e vendimit të Këshillit kështu duke e rivlerësuar ankuesin me notë të përgjithshme 2.2, ndërsa nga Vlerësuesi për periudhën 01.01.2021 deri 13.07.2022 është vlerësuar me notë të përgjithshme 3.7.

Ankuesi i pa kënaqur me rivlerësimin përfundimtarë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për vitin 2021 periudhën 28/07/2021 deri më 31/12/2021 me datë 25.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3019/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.477/2022 me numër të protokollit 3019/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 25.05.2022 përmes e-mailit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.08.2021 ref.02/N.112 i protokolluar me datë 24.08.2021 me nr.protokollit 6025; E-mail zyrtar i datës 15.2021 bashkë me foto; Rregullore Nr.29/2012 për Organizimin dhe Sistematizimin e e Vendeve të Punës të ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Vendimi i datës 20.08.2021 me numër protokollit 6024; Formulari i për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike -2021 , data e vlerësimit (1 janar-13 korrik 2021; Vendimi A.nr.159/2022 i datës 08.04.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionali datës 26.04.2022; Akt emërimi i ankuesit i datës 21.06.2019; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar për të hyra financiare i datës 03.03.2017 dhe E-mail zyrtar i datës 31.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje meritorishtë, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit se është i pa kënaqur me rivlerësimin përfundimtarë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt prej datës 28.07.2021 deri më 31.12.2021 për vitin 2021 si dhe ka theksuar se me rastin e rivlerësimit Udhëheqësi i drejtpërdrejtë është bazuar në vërejtjen me shkrim të datës 15/12/2021 që më është vendosur në dosje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshme sepse në bazë të provave të lëndës është konstatuar se rivlerësimi i ankuesit është bërë në pajtim me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, respektivisht në pajtim me nenin 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 ku përcaktohet se *„Vlerësimi i rezultateve në punë - nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me këtë Rregullore”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale me rastin e rivlerësimit të ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 5 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se rivlerësimi i datës 26.04.2022 për rezultatet e punës për ankuesin për periudhën janar - dhjetor 2021, është bërë pozitiv e që është në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 dhe paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.4. nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “shumë mirë” si dhe 2. Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: 2.2. “shumë mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”, dhe në rastin konkret Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka pas parasysh edhe faktin se vlerësimi përfshin arritjen e objektivave për ankuesin në bazë të detyrave të punës dhe ankuesit vlerësimi i punës për periudhën 1 janar 2021-13 korrik 2021 është vlerësuar me notë të përgjithshme 3.8 ndërsa për periudhën 28 korrik deri 31.12.2021 është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.2, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë vetëm për periudhën e rivlerësimit për periudhën 28 korrik deri 31.12.2021 ku është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.2.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesi është rivlerësuar drejtë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, sepse nota e përgjithshme pas rivlerësimit është në pajtim me komentet, dhe rrjedhimisht në rastin konkret udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit pas rivlerësimit ka respektuar dispozitat e

nënit 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 paragrafit të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetarit të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.477/2022, datë 06.07.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Pronësi Industriale /MINT;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.